



**Re, Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,
në Eskisehir Technical University/TÜRKIYE**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Eskisehir Technical University/TÜRKIYE.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime.

Kohëzgjatja e bursave: Semestri i dytë, i vitit akademik 2024 – 2025.

Fushat dhe nivelet e studimit:

- Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Interior Design program at the Bachelor's, Master's, and Doctoral levels;
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike - Textile and Fashion Design program at the Bachelor's and Master's levels.
- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Bachelor's, Master's and Doctoral levels.
- **Bachelor** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe te kenë përfunduar vitin e parë akademik).
- **Master** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës).
- **Doktoral** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Doktoral në Universitetin Politeknik të Tiranës).

Numri total i studentëve: 2 studentë

1 student për Projektin: Erasmus+ KA171 credit mobility program, projects **2023-1-TR01-KA171-HED-000167433**, (Për studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës dhe studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike).

1 student për Projektin: Erasmus+ KA171 credit mobility program, project **2022-1-TR01-KA171-HED-000069220**, (Për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit).

Sasia përfundimtare e studentëve, për të dy projektet, do të varet nga Eskisehir Technical University.

Shuma e grantit: 800 Euro në muaj + një pagesë një-herëshe prej 275 Euro për mbështetjen e udhëtimit*.

*Në rast të përdorimit të mënyrave të transportit më të gjelbërta dhe më miqësore ndaj mjedisit, të cilat reduktojnë emetimet e karbonit dhe përputhen me standardet ekologjike, shuma e mbështetjes së udhëtimit rritet në 320 Euro.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;



Key Action 1
– Mobility for learners and staff –

- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Eskisehir Technical University lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ te seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e ‘‘Learning Agreement’’ klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 2.

Për t’u njohur me lëndët që ofrohen në Eskisehir Technical University, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni në link-un: ESTU [here](#).

Informacion mbi akomodimin:

<https://uib.eskisehir.edu.tr/en/Icerik/Detay/accommodation>

Afati për aplikim: Deri më 30 Tetor, 2024, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al